



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 2148/Prot.

3
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 23.8.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QËNDRA NDËRUNIVERSITARE E SHËRBIMEVE DHE RRJETIT TELEMATIK

Nr. 17117 Prot.

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 23.08.2017

MARRËVESHJE

**“PËR KOMUNIKIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE TË KANDIDATËVE PËR
STUDENTË NË IAL PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018 NGA QENDRA E
SHËRBIMEVE ARSIMORE TEK QENDRA NDËRUNIVERSITARE E SHËRBIMEVE
DHE RRJETIT TELEMATIK”**

Kjo marrëveshje lidhet ndërmjet:

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE (më poshtë QSHA), e përfaqësuar nga Znj. Rezana Vrapit,
Drejtoreshë e Përgjithshme e këtij institucioni

dhe

**QENDRËS NDËRUNIVERSITARE TË SHËRBIMEVE DHE RRJETIT TELEMATIK (më poshtë
QNSHRTT), e përfaqësuar nga Z. Arjan Xhelaj, Drejtor i këtij institucioni.**

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje lidhet ndërmjet QSHA-së dhe QNSHRRT-së, me qëllim përmbushjen e detyrave që burojnë nga Udhëzimi nr. 15 datë 19.05.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2017-2018".
2. Marrëveshja lidhet në kuadër të kompetencave të QSHA-së sipas ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore" dhe kompetencave të QNSHRRT-së sipas ligjit nr.9704, datë 02.04.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 06.03.2009 "Për krijimin e qendrës ndëruniversitare të zhvillimit të telematikës", i ndryshuar si dhe bashkëpunimit ndërinstitucional sipas Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 59 datë 09.02.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për pranimet në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin Akademik 2017-2018".
3. Publikimi i të dhënave në portalin U-Albania, i cili administrohet nga QNSHRRT bëhet me qëllim dhënien online të informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve si dhe me qëllim përmbushjen e regjistrimit online nga sekretaria e IAL-ve.

Neni 2

Mënyrat e bashkëpunimit

1. QSHA-ja do të përhapë në formë dixhitale dhe në mënyrë automatike nëpërmjet protokollit FTP informacionet e mëposhtme:
 - a) listën e kandidatëve me programet e studimit të përzgjedhura;
 - b) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme për secilin kandidat për student;
 - c) rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore për secilin kandidat për student;
 - d) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
 - e) mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
 - f) mesataren e përgjithshme të përlogaritur sipas VKM-së nr. 346 datë 19.04.2017;
 - g) indekset e profileve të shkollave të mesme.
2. Përhapja e të dhënave do të kryhet:
 - a) brenda datës 23.08.2017 për raundin e parë,
 - b) brenda datës 27.09.2017 për raundin e dytë.

4. Aksesit në këto të dhëna do të realizohet vetëm nga persona të autorizuar nga QNSHRRT-ja dhe në funksion të kësaj Marrëveshje.

Neni 3

Të drejtat

1. Me qëllim për të arritur objektivat e kësaj marrëveshje, të dy palët nënshkruese do të kenë këto të drejta, si më poshtë:

- a) Të shkëmbejnë dhe të kërkojnë informacion lidhur me të dhënat që transferohen;
- b) Të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të organizuara nga secila palë;
- c) Të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e përbashkëta;
- d) Të mundësojnë vizita dhe kontakte direkte ndërmjet dy institucioneve.

2. QNSHRRT-së i jepet e drejta e mbajtjes së të dhënave personale të përhapura deri më datë 31.10.2017. Mbas përfundimit të këtij afati të dhënat do të shuhet me anë të skripteve që fshijnë memorjen e databazës.

Neni 4

Detyrimet e QSHA-së

1. QSHA-ja garanton që të dhënat personale që transferohen për përpunim tek QNSHRRT-ja janë mbledhur dhe përpunuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. QSHA garanton gjithashtu që komunikimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek QNSHRRT-ja është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. QSHA-ja është e detyruar që:

- a) Përpara se të nënshkruajë marrëveshjen dhe të transferojë të dhënat, duhet të informojë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale sipas dispozitave të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar;
- b) Përpara se të nënshkruajë marrëveshjen dhe të transferojë të dhënat të informojë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
- c) Të verifikojë masat teknike dhe organizative të ndërmarra nga QNSHRRT-ja për sigurimin e mbrojtjes së mjaftueshme të të dhënave personale.

Neni 5

Detyrimet e QNSHRRT

1. QNSHRRT-ja është e detyruar që të përpunojë të dhënat personale të marra nga QSHA dhe çdo të dhënë tjetër që rrjedh prej këtij përpunimi:

a) Vetëm për qëllimet e përcaktuara në ligjin e krijimit të saj dhe në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

c) Në përputhje më këtë Marrëveshje.

2. QNSHRRT-ja është e detyruar të respektojë regulloren e saj të brendshme për mbrojtjen, përpunimin, sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave personale.

3. Përpara fillimit të komunikimit QNSHRRT-ja merr të gjitha masat teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të dërguara nga Kontrolluesi nga çdo përpunim i paautorizuar, duke përfshirë shkatërrimin, humbjen, përhapjen e paligjshme apo dëmtimin e tyre. Titullari i institucionit ngre grupin e punës të cilit i autorizon hyrjen në databazë përkatëse.

4. QNSHRRT-ja njofton menjëherë QSHA-në në rastet kur:

a) Është në pamundësi të vazhdojë zbatimin e kësaj marrëveshje;

b) Ka ndodhur një prekje aksidentale apo a pa-autorizuar e të dhënave personale.

Neni 6

Komunikimi

Palët bashkëpunuese në këtë marrëveshje përfaqësohen nga titullarët e institucioneve përkatëse si persona zyrtarë. Titullarët mund të delegojnë kompetencat koordinuese personave të tjerë, nëse kjo shihet e arsyeshme.

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 8

Afatet dhe përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi deri më 31.10.2017.

2. Në çdo rast, QNSHRRRT-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara apo të dhënave që kanë rrjedhur prej këtij përpunimi.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve, pasi është marrë më parë mendimi për nënshkrimin e saj nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme dhe përfundimtare



1. Një kopje e kësaj marrëveshje i vihet në dispozicion Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrin të Arsimit dhe Sportit menjëherë pas nënshkrimit, apo subjektit të të dhënave në rast kërkesë.
2. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk çenojnë apo ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet që u burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim.
4. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe dy të tjera në Qendrën Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u lidh sot në Tiranë, më datë: 23.07.2017.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore:

Drejtori i Përgjithshëm

Znj. Rezana VRAPI



Për Qendrën Ndëruniversitare të Shërbimeve

dhe Rrjetit Telematik:

Drejtori

Z. Arjan XHELAJ

